



Përmirësimi i shërbimeve vendore me pjesëmarrjen e vëzhguesve të kualifikuar

Konteksti i projektit

Instituti i Kërkimeve Urbane ka ndarë me stafin e Komunës dhe qytetarët përvojën e tij në vlerësimin e shërbimeve vendore me pjesëmarrjen e qytetarëve dhe përmirësimin e procesit të buxhetit të fokusuar në këto rezultate.

Metodologjia e projektit

Metoda e vlerësimit me vëzhgues të kualifikuar (VVK) që u ndoq sjell një shkallë e lartë të pjesëmarrjes qytetare në vendimmarrje, sepse nëpërmjet vlerësimit të kushteve të shërbimit në terren, u krijua një informacion mjaft lehtësues dhe transparent që komunikon shumë mirë me qytetarët, i bën ata aktivë në përcaktimin e prioriteteve dhe ndihmon stafin e NjQV dhe Këshillin në proceset vendimmarrëse. Vëzhgues të kualifikuar janë grupe qytetarësh vullnetarë të profesioneve të ndryshme, jo të punësuar nga bashkia, por që bashkëpunojnë me stafin e NjQV duke punuar me komunën e Rrashbullit, të cilët janë të trajnuar për të përdorur të njëjtën metodë vlerësimi në terren. Vëzhgues të kualifikuar mund të vlerësojnë kushtet fizike, si gjendjen e rrugëve dhe ndërtesave, të bazuar në një metodë të thjeshtë, duke vendosur kushte nga 1-5 nga një grup i fotosh. Vëzhguesit krahasojnë kushtet aktuale nën vëzhgim të udhëzimeve të shkruara dhe fotografike të përcaktuara se cilën mënyrë vlerësimi të caktojë. URI propozon krijimin e një sistemi me vëzhgues të kualifikuar në Rrashbull, për të vlerësuar kushtet fizike të pastërtisë dhe kushteve të rrugëve.

Mbas një trajnimi të përshtatshëm, 22 pjesëtarët e grupit të Vëzhguesve të Kualifikuar, duke përdorur të njëjtat

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë në kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.



direktiva të shkruara apo me anë të fotografive, do të prodhojnë vlerësime të krahasueshme. Direktivat fotografike, konsistojnë në disa foto të përzgjedhura që tregojnë kushte tipike që përkufizojnë vlerën e vlerësimit, për element të ndryshëm të rrugës.

Vlerësimet kryhen nga vëzhguesit e trajnuar, mbasi kanë marrë trajnimin e duhur nga stafi i IKU. Mbas kësaj, vëzhguesit krahasuan kushtet aktuale nën vëzhgim të direktivave fotografike apo të shkruara, për të vendosur se cilën mënyrë vlerësimi të caktojë për element të ndryshëm të rrugëve dhe pastërtisë, si trotuari, koshat e mbetjeve, mbetjet etj.

Personat e tjerë të ekipit mund lehtë të kuptojnë këto vlerësime pasi të kenë treguar udhëzimet e përdorur për ti kryer ato. Vlerësimet u shoqëruan me caktimin e kostos së çdo problemi të identifikuar, dhe më pas me prioritizimin e këtyre problemeve dhe kostoja u bë publike dhe ju dha këshillit të komunës për qëllime të shpërndarjes së buxhetit.

Hapat e projektit

1. Identifikimi i kushteve të aspektit fizik që janë më të rëndësishme.
2. Zhvillimi i masave objektive të aspekteve të gjendjes fizike.
3. Përkufizimi i problemeve për secilin aspekt.
4. Zhvillimi dhe dokumentimi i notave për secilin kusht që duhet të matet.
5. Zhvillimi i procedurave/formave për mbledhjen, përpunimin dhe regjistrimin e të dhënave për secilin element të vlerësuar.

Vlerësimi nga grupi i punës i dokumentit të buxhetit të Komunës nga pikëpamja e komunikimit të tij me qytetarët dhe përgatitja e rekomandimeve për stafin e këshillin, beri të mundur që grupi qytetar të sjelle në takimet e hapura publike të diskutimit të buxhetit për shërbimet e zgjedhura rreth 80 banorë të Komunës.

Nga ana tjetër kryetari i Komunës dhe këshilli rritin kërkesën ndaj stafit për të përmirësuar paraqitjen e dokumentit të buxhetit nga pikëpamja e thjeshtësisë dhe kuptueshmërisë së tij nga banorët.

Zbatimi i këtij programi përmirësoi buxhetin aktual të Komunës, nga një buxhet vetëm në vlerë (lek) në një buxhet të orientuar ndaj rezultateve, ndaj objektivave të matshme në kohë për një periudhë afatmesme.

Komuna duke përdorur rezultatet dhe raportin e vlerësimit qytetar të shërbimeve ndërmori veprime konkrete, pa shtese fondesh, për të përmirësuar shërbimin e pastrimit, nëpërmjet riorganizimit të kontenerëve, ndërgjegjësimit të banoreve për të hedhur mbetjet në vendet e caktuara nga Komuna si dhe rritjes së kontrollit ndaj sektorit të shërbimit komunal, për cilësi më të mirë shërbimi.

Ky projekt i zbatuar në këtë Komunë i shërbeu jo vetëm përmirësimit të metodës së buxhetimit me pjesëmarrjen e qytetareve, por i gjithë dokumentacioni analitik i vlerësimit të cilësisë aktuale të rrugëve dhe pastrimit për çdo fshat, saktësoi treguesit bazë të rezultatit, që do të ndihmojnë stafin për përcaktimin e objektivave të qarta gjatë proceseve të buxhetimit bazuar në menaxhimin në baze të performancës.



FAKTET KRYESORE

PARTNERET

- ✓ Ambasada Amerikane

KOHËZGJATIA:

Tetor 2012 – Qershor 2013

PËRFITUESIT:

- ✓ Komuna Rrashbull

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llojmë qeverinë, trajnojmë njësitë e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.